



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 46 al. 2 të Ligjit për planifikimin dhe rregulimin e hapsirës (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 2/89), nenit 3 të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më.13.06.2003 merr

V E N D I M
MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT ME DESTINIM PËR NDËRTIMIN E
OBJEKTIT TË SHKOLLËS SË MESME-GJIMNAZI “XHEVDET DODA”
NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit me destinim për ndërtimin e objektit të shkollës së mesme-gjimnazi “Xhevdet Doda” në Prishtinë

Neni 2

Me këtë Vendim caktohet lokacioni me destinim për ndërtimin e objektit të shkollës së mesme-gjimnazi “Xhevdet Doda” në Prishtinë.

Lokacioni nga alinea 1. e këtij neni, përfshin pjesët e ngastrave kadastrale nr. 7156, 7158, 7159, 7160, 7161/1, 7161/2, 7161/3, 7162/1, 7162/2, 7162/3 Komuna Kadastrale Prishtinë, sipërfaqja prej 3.00.00 ha.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për hartimin e Projektit Urbanistik të lokacionit nga alinea 2 e nenit 2 e këtij Vendimi, në bazë të të cilit do të caktohen kushtet urbanistike-teknike për lejimin e ndërtimit të objektit investiv nga neni 2 i këtij Vendimi.

Projekti Urbanistik nga alinea 1 e këtij neni, do të punohet nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë të Komunës së Prishtinës sipas programit të prezentuar nga investitori.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtorati për Financa dhe Pronë, të Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar për realizimin e këtij vendimi

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 353-1120 DT. 19.06.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri